



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21 Prill 2021

Nr: 263

**VENDIM**

**PËR**

**MIRATIMIN E VËZHguesve Afatshkurtër dhe Përkthyesve të Ambasadës Kroate, Gjermane, Sllovene dhe Italiane për Vëzhgimin e Zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021.**

Në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.2, datë 02.02.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediae dhe subjektet zgjedhore”, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

**VENDOS:**

1. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Kroate për akreditimin e 3 (tre) vëzhguesve afatshkurtër dhe 1 (një) përkthyesi, për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Gjermane për akreditimin e 4 (katër) vëzhguesve afatshkurtër dhe 3 (tre) përkthyesve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 2, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Sllovene për akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër dhe 1 (një) përkthyesi, për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Të miratojë kërkesën e Ambasadës Italiane për akreditimin e 7 (shtatë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 5 (pesë) përkthyesve, për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes 4, bashkëlidhur këtij vendimi
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**Ilirjan CELIBASHI**

